



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 230/3 Prot.

Tiranë më 13.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 09, datë 13.02.2019

PËR KONTROLLUESIN "AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 40 datë 08.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*", me objekt:

- Zbatimi i nenit 18 dhe 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor është institucion qendror publik, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë në Shqipëri dhe zbaton politikën kombëtare për infrastrukturën e informacionit gjeohapësinor duke përfaqësuar shtetin në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, anëtarësimi në të cilat i shërben funksionimit dhe modernizimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka "*Njoftuar*" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar: "...Njoftimi

duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur një rubrikë “politikat e privatësisë” në portalin <http://www.asig.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në “*Politikat e Privatësisë*”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika 1: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale... ”.*
3. Formulari me titull “*Kërkesë për informacion*”, përmban të dhëna personale të qytetarëve, kontrolluesi ka marrë masa për të vendosur referencën ligjore mbi të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit (ASIG) në kuadër të mbrojtjes së këtyre të drejtave.
4. Konstatohet se kontrolluesi informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave “*nëpunës*”, “*vizitorë*”, etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), tabelat janë të plotësuara në përputhje me formatin e miratuar sipas Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin i cili u lexua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se nuk ka pretendime, por nga institucioni po ndërmerren masa për rikuperimin e konstatimeve të lëna nga grupi i kontrollit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “*Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*” në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet rubrikës “*Politikat e Privatësisë*” në portalin zyrtar <http://www.asig.gov.al>.
2. Kontrolluesi “*Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*” në zbatim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr.9887/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit “*Njoftimin*” në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.

3. Kontrolluesi "Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.02.2019.

